

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
AIR KOSOVA SHPK
Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar**

**Kreu I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**FORMIMI I SHOQERISE
Neni 1**

1. Sot ne Tirane ne daten 30 Dhjetor 2024 themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **"AIR KOSOVA"** shpk me vullnetin e lire te ortakut mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar. Shoqeria "AIR KOSOVA " shpk formohet nga Ortaku I vetem themelues :

Shoqeria "Global Technical Mechanics" SHPK, shoqeri tregtare themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe regjistruar prane QKB ne 29.03.2017 me NUIS L71529026M dhe adrese te selise qendore: Kukes Shtiqen Kukes Njesia Administrative Shtiqen (Aeroporti I Kukesit).

**FORMA dhe EMERTIMI
Neni 2**

1. Shoqeria tregtare, eshte organizuar si Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.
2. Emertimi I Shoqerise eshte: "AIR KOSOVA" SHPK
3. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e Shoqerise

**SELIA E SHOQERISE
Neni 3**

1. Shoqeria tregtare "AIR KOSOVA" shpk, ka seline qendore ne territorin e Republikes se Shqiperise Kukes Shtiqen Njesia Administrative Shtiqen (aeroporti I Kukesit).
2. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi apo agjenci ne qytetet te tjera te Shqiperise apo jashte vendit.
3. Ajo mund te jete pjesemarrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
4. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme dp te krijohen ne perputhje me kegjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e tij.
5. Shoqeria do te kete vulen e saj.

**KOHEZGJATJA
Neni 4**



1. Shoqëria "Air Kosova" shpk do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar, nga regjistrimi i saj në Regjistrin tregtar, QKB.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktimin e mevonshëm me lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasoje krijimin e një personaliteti të ri juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin si vijon:

Ushtrimi i aktivitetit të linjave ajrore për transportin e personave, të mallrave dhe postës, jo vetëm në udhetime të linjes por edhe me udhetime jo të linjes (charter). Shoqëria do të kryejë të gjitha llojet e transportit ajror vendas dhe ndërkombëtar për pasagjerët, postën, kafshët dhe mallrat, si dhe të gjitha punët dhe angazhimet që lidhen me to, duke përfshirë pa u kufizuar në shërbimet e furnizimit me ushqim, përpunimit në tokë dhe salla biznesi si dhe operimin tregtar të avionëve /riparimit dhe mirëmbajtjes së avionëve si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi.

2. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të shtohet/ ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

TE DREJTAT E SHOQËRISË

Neni 6

Shoqëria tregtare nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000,000 Leke (një milion leke), i cili është teresisht Kapital Financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1,000,000 leke (një milion leke) e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm.

Pronar dhe Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

Shoqëria "Global Technical Mechanics" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 29.03.2017 me NUIS L71529026M dhe adresë të selisë qendrore: Kukes Shtiqen Kukes Njesia Administrative Shtiqen (Aeroporti i Kukës), zotëruar nga 1 (një) kuotë e cila përben 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar me vlerë 1,000,000 leke (një milion leke).

Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të pakesojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

Ne perputhje me Ligjin Nr. nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar si dhe Aktin e Themelimit, pergjegjesia e Ortakut te vetem eshte e kufizuar deri ne vleren e pashlyer te kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

Neni 9

1. Perberja e Kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj dhe perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohet nga Ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise si dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

Neni 10

1. Shoqeria tregtare eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veorimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejtat materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike, juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 11

Kuotat e kapitalit te Shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim me akt noterial. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

Neni 12

Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar me vendimin perkates.

Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.
Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

KREU II

ORTAKERIA

Neni 13

Ortaket e shoqerise tregtare gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise ne aktin e themelimit dhe ne statutin e Shoqerise.

Te drejtat dhe Detyrat e Ortakeve

Neni 14

1. Te marre pjese ne mbledhjet e Asamblejse se ortakut duke ushtruar te drejten e votes.
2. Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktiviteti dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit;
3. Te informohet mbi permbajtje ne raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Te perfitoje nga fitimi i shoqerise;
5. Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara.

KREU III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PERGJITHSHEM

Neni 15

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me I larte vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statudit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem ne rast se shoqeria eshte themeluar nga nje ortak i vetem. Ortaket mund t'i delegojne kompetencat e tyre me shkrim ne formen e autorizimit oe me prokure. Cdo klauzole e kundert eshte e pavlefshme ne kete rast.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

Administratoret therrasin Asamblene e Pergjithshme dhe me kerkesen e ortakeve, Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese te derguar me poste ose poste elektronike (email) drejtuar cdo ortaku, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi me shkrese ose mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e duhet te dergohet jo me vone se 7 dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitha ortaket jane dakort per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vete me arritjen e kuoromit te parashikuar nga Ligji. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (conference call), audio ose audio-video.

Neni 16 **Detyrat e Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja vendos per ceshtje si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d te ketij Neni;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire mbikqyrjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjes se Asamblese;
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;
- n) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- o) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- p) Investime;
- q) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- r) Te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- s) Per shperndarjen e fitimit.

Te zbateje kriteret e caktuara nga ligji ne fuqi per punetoret dhe nepunesit qe punesohen ne shoqeri.

Kreu IV **Administrimi**

Neni 17 **Emerimi i Administratoreve**

Asambleja e Pergjithshme sipas percaktimeve te bera ne ligj emerone nje ose me shume persona si Administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare i cili mund te jete ose jo ortak i shoqerise.

Shoqeria me krijimin e saj do te kete nje administrator te vetem. **Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripерteritje.**

Te dhenat e Administratorit dhe Identifikimi:



Z. Ridgers Mema shtetas shqiptar, lindur ne 03.12.1992 ne Marrez, Shqiperi me banim ne Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr. BB7246410 me Nr. personal J21203062A.

Neni 18

Kompetencat e Administratoreve

Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga Administratori i cili mund te ushtroje te gjitha kompetencat qe nuk i rezervohen Asamblese se Pergjithshme sipas Ligjit. Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat qe te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredhenie me te tretet. Administratori nuk mund te delegoje detyrimet e tij ligjore. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) Perfaqesoj shoqerine tregtare ne marredheniet me te tretet e ne administraten publike;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) Krijone nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) Kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare Regjistrimit;
- g) Raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme edhe ne rastet kur:

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 perqind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjithave shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Shperblimi, perfitimit dhe Shpenzimet e Administratoreve caktohen nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e Ligjit.

Kreu V

BILANCI, DIVIDENTET DHE KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR

Neni 19

Bilanci

Bilanci i shoqerise fillon ne 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga administratori miratohen nga Asambleja. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 20

Dividentet

Pas plotesimit te parashikimeve te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividenteve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

Neni 21

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne Ligj, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividente apo shuma te tjera te parashikuara ne rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu VI

PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 22

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme
- c. Me vendim te procedurave te Falimentit
- d. Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje Ligjin
- e. Me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 23 Njoftimet

Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim te cilat do te dergohen me poste ose nepermjet komunikimit elektronik dhe sipas specifikimeve te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin dhe sipas percaktimeve ne ligj.

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences te shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do te paraqiten per zgjidhje Gjykates kompetente shqiptare.

Neni 24 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" I ndryshuar, Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe secili me te njejten vlere ligjore. Njeri prej tyre ruhet ne dokumnetacionin baze te shoqerise.

Ortaku i vetem
Global Technical Mechanics SHPK
Perfaqesuar nga Ortaku i vetem
Z. RIDGERS MEMA



(emer, mbimer, nenshkrim)

